REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
Datum: 29 06 22
Nj. Org | | | Vlera
01 | 052 | 31639

# Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile

## Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor

Qershor
2022



# HYRJE

- Buxheti është një plan i të hyrave dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohore që hartohet dhe rivlerësohet në baza periodike. Buxhetimi komunal është proces themelor që lejon komunat të arrijnë shumë qëllime në rrjedhën e tyre të veprimit. Procesi i formulimit të një plani buxheti është një nga aktivitetet kryesore të çdo komune për vitin e ardhshëm me qëllim plotësimin e nevojave zhvillimore së bashku me nevojat e qytetarëve.

- Buxheti si akt më i rëndësishëm komunal shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend Komunal në baza vjetore bazuar në parashikime afatmesme tri vjeçare. Institucionet komunale kanë kompetenca që ndikojnë në kualitetin e jetës së qytetarëve.

- Buxheti që hartohet çdo vit nga të hyrat e parasë publike, përcakton se çfarë projekte dhe shërbime do t'u ofrohen qytetarëve, andaj duhet të jetë i shpërndarë mirë dhe i konsultuar me qytetarët. Me konsolidimin e qeverisjes lokale, buxhetet komunale janë rritur dukshëm dhe janë bërë të rëndësishëm për zhvillimin e lagjeve dhe fshatrave.





- Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen dëgjime publike me qëllim të mbledhjes së prioriteteve nëpër secilin vendbanim varësisht prej kërkesave që kanë banorët, për t'l harmonizuar pastaj në draftim të politikave lokale përfshirë buxhetin.

- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas pranimit të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (siç e sheh të arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të informohen qytetarët për takime publike, përfshirë dëgjimet buxhetore dhe detajon procedurat për mbarëvajtjen e tyre.

- Në bazë të nenit 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 61 paragarafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048, neni 17, 18 pika 1.7 dhe 19 i Statutit të Komunës së Drenasit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizojnë dëgjime publike rreth përgatitjes së buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023.

# KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2023-2025

**Korniza Afatmesme Buxhetore KAB është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga asambleja komunale.**



Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave, prioriteteve, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integrimit sa më të mirë në procesin buxhetor.

- **Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2022/01, të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).**

- **Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2023-2025.**

# Njoftimi për takim për dëgjimin publik – Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025

Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 03.06.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
01-060/05-25320

**Ftesë**

**Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025**

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, Shoqatat e grave, shoqëria civile, bizneset dhe profesionistët, se Komuna e Drenasit, përkatësisht kryetari z. Ramiz Lladrovci, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet e Financave, se më datën **07, 08 dhe 09 Qershor** do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të diskutuar Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025.

Korniza Afatmesme Buxhetore është e një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoni të drejtën e juaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike. Takimi do të jetë një proces i dëgjimit që do të shërbej për vendimmarrje, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja. Ju do të kontribuoni që kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore Komunale dhe Lista e investimeve kapitale të jetë sa më e kompletuar dhe cilësore për të përmirësuar jetën e tuaj.

Takimet për planifikim të buxhetit do të zhvillohen me këtë rend dite:

1. Informate e përgjithshme lidhur me buxhetin komunal 2023-2025
2. Lista e investimeve kapitale
3. Kërkesat e banorëve

Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes se dëgjimit, datën dhe vendbanimet e përfshira:

| Vendbanimet ku do të mbahen dëgjimet dhe përfaqësuesit | Data dhe ora e dëgjimeve | Vendi |
|---|---|---|
| Drenas<br>Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëria Civile | E martë<br>07.06.2022<br>Ora 10:30 | Salla e Kuvendit në objektin e Komunës |
| Drenas<br>Për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor | E martë<br>07.06.2022<br>Ora 13:30 | Salla e Kuvendit në objektin e Komunës |
| Bashkësia lokale e Dobroshecit (Gradicë, Likoshan, Gudanc, Dobroshec, Gllanasellë dhe Çikatovë e Vjetër) | E mërkurë<br>08.06.2022<br>Ora 10:20 | ShFMU "Rilindja" Dobroshec |
| Bashkësia Lokale Tërstenik (Tërstenik I dhe II, Vërboc, Poluzhë dhe Shtutiçë) | E mërkurë<br>08.06.2022<br>Ora 13:15 | ShFMU "Zenel Hajdini" Tërstenik |
| Bashkësia Lokale Baicës (Abri, Tërdec, Baicë, Krajkovë dhe Dumanek) | E mërkurë<br>08.06.2022<br>Ora 14:45 | ShFMU "Migjeni" Baicë |
| Bashkësia lokale Arllatit (Arllat, Llapushnik, Negroc, Vuçak, dhe Gjergjicë) | E enjte<br>09.06.2022<br>Ora 10:20 | ShFMU "Abedin Bajrami" Arllat |
| Bashkësia lokale e Komoranit (Kizharekë, Nekoc, Fushticë e Ulët dhe e epërme, Korroticë e ulët dhe e epërme, Zabel i ulët dhe i Epërm dhe Sankoc) | E enjte<br>09.06.2022<br>Ora 13:45 | ShFMU "Xheladin Gashi - Plaku" Komoran |
| Drenasi me zonat dhe fshatrat përreth (Drenasi I, II, dhe III, Poklleku i Ri dhe i Vjetër, Vasilevë, Gllobar dhe Shtrubullovë) | E enjte<br>09.06.2022<br>Ora 14:40 | ShFMU "Rasim Kiqina" Drenas |

Ju mirëpresim!

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

# Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor – Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile



## Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile



# Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile



# Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile



# Lista e nënshkrimeve - Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2023/2025 me Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëria Civile - 07.06.2022

| Nr | Emri dhe mbiemri | Fshati/vendbanimi | Nr. Telefonit | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ramiz Hadrolli | | 049/977 999 | |
| 2 | Bekim Dobra | Drenas | 049 977 799 | |
| 3 | [illegible] | DRENAS | 044/374-929 | |
| 4 | LARETA THAQI | DRENAS | 049/642/092 | |
| 5 | ENDRIT [illegible] | DRENAS | 049/258/913 | |
| 6 | Muhamet Gjoka | Terstenik | 043800029 | |
| 7 | Flutura [illegible] | Zabel i Ulët | 043 978 021 | |
| 8 | Arsim [illegible] | Drenas | 044 170 826 | |
| 9 | Egzon Jetullahi | Sankoc | 044/298-772 | |
| 10 | [illegible] | Zabel i Ulët | 044/101-873 | |
| 11 | Shpetim Avdyli | Drenas | 043 291 253 | |
| 12 | [illegible] Bajraktari | Drenas, Kos. | 044-170-755 | |
| 13 | Rezarta Prokshi | Vërboc | 043-261-880 | |
| 14 | [illegible] Zymberi | Poklek i Ri | 049-929-932 | |
| 15 | ALBERT [illegible] | Tërdec | 45-361-385 | |
| 16 | Adhurim Haxha | Damanek | 049 259 597 | |
| 17 | Erlind Krasniqi | Negroc | 049 978 030 | |
| 18 | Fatmir Hadroni | Gllanasellë | 049 377 998 | |
| 19 | AVDYL MZIU | KOMORAN | 049221880 | |
| 20 | Arsim Azemi | KOMERAN | 044 823312 | |
| 21 | [illegible] | DRENAS | 049922 900 | |
| 22 | GRANIT KRASNIQI | Gllanasellë | 049 560 199 | |
| 23 | Egzona Tërdevci | Gllobar | 049-450-737 | |

# Format fizike të listës së projekteve kapitale dhe informatat lidhur me buxhetin komunal 2023-2025 që ju shpërndanë të pranishmëve


KOMUNA E DRENASIT
LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2023-2025

| Prog | Emri i Projektit | Financimi | Totali | Vlerësimi për 2024 | Vlerësimi për 2025 | Totali 2023-2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |




# Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor -Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile

**Takimin e hapi Bekim Dobra - Shef i Zyrës për Komunikim me Publikun, i cili pasi përshëndeti të pranishmit i njoftoi ata se para vetës kanë draft-propozimin në formë fizike ku do të mund të marrin informatat ë përgjithshme për dëgjimet buxhetore dhe projeksionet buxhetore të Komunës së Drenasit.**

- ***Bekim Dobra*** - Komuna e Drenasit ka filluar dëgjimet publike buxhetore për të marrë kërkesat e qytetarëve për projektet e vitëve vijuese 2023-2025.
- Në këto takime nuk është paraparë që të diskutohët për projektet që janë në proces e sipër.
- E ftojë kryetarin Lladrovci për një fjalë përshëndetëse

- ***Kryetari Lladrovci*** – përshëndetje për të gjithë, ju falenderojë për pjesëmarrje gjithë të pranishmëve, sepse prezenca juaj është kontribut shtesë për procesin e vlerësimit të Komunës ku nëpërmjët së cilës fitojmë grante.

- **Sqarohet për diskutim** – projektet në proces nuk diskutohen në këto takime sepse janë të parapara diskutimet për projektet e ardhshme në vitet vijuese .
- Kërkojë nga ju të na përcjellni për projektet që janë të dedikuara për vendbanimin tuaj.

- Nuk po e zgjati më shumë sepse këtu jam për të marrë kërkësat e juaja të përcaktojmë investimet në zonën tuaj.
- **Rregullat e takimit** – Duhet të prezantoheni paraprakisht për shkak që është duke u mbajtur procesverbali.

# Hapet diskutimi për pjesëmarrësit

- Eset Bajraktari (Përfaqësues i Bashkësisë Islame në Drenas) – Fillimisht përshëndes kryetarin Lladrovci me bashkëpuntorët e tij, përshëndes të gjithë të pranishmit, meqenëse Drejtoria për Shërbime Publike qenka renditur prej të parave për të cilën do të flas edhe unë për të diçka. Kryetari Lladrovci e potencoi mire që tha është mire që paraprakisht të bëhen kërkesat pa u planifiku buxheti që pasandej me u shqyrtu mundësia dhe arsyetimi i asaj kërkese. Ne si Bashkësi Islame vazhdimisht për disa vite me radhë e dini me projektin e shërbimeve të varrimit, kemi diskutuar me organet kompetente të komunës, por prej fillimit e deri më tani nuk kemi mundur të rrisimin cmimin e procesit të shërbimit të varrimit sepse është nevoja se janë rritur të gjitha cmimet e shërbimeve e artikujve dhe e kemi problem me cu deri në fund. Kërkojmë nga komuna dhe drejtoria përkatëse të shqyrtojë rritjen e vlerës për shërbimin e varrimit sepse po rrezikohet seriozisht ky shërbim.

- Kemi pasur vërejtje vazhdimisht sidomos në shtyllën e pare ku kemi pasur hapjen e varrezave, punëtorët apo ekipa që kryen këtë varrim kemi pasur vazhdimisht problem me ta, sepse cmimi 50 euro për varrim prej tyre është I paarsyeshëm, prandaj kërkojë të shqyrtohet mundësia që ky shërbim të rritet dhe të bëhet konform situates aktuale. Po e shoh që janë bërë nga 50 mijë euro, për rrethim dhe pastrim të varrezave, e shoh si dicka shumë positive sepse është shumë e nevojshme. 50 mijë euro janë ndihmë e madhe pavarësisht se asnjëherë nuk është boll sepse ka nevoja të mëdha por sidoqoftë nëse shfrytëzohen në mënyrë të mire do ndihmojnë këtë proces.

***Arben Shala (Nënkryetar i Komunës së Drenasit)*** – Po flas si banor i fshatit Vucak, e shikova listen me shumë vëmendje, sa i përketë fshatit Vuçak po e shoh që gjatë kësaj periudhe nuk është paraparë asnjë investim. Është fakt që janë bërë investimet të mira në atë vend, rruga për Tërdevc, megjithatë mendojë që ende janë disa nevoja sa I përketë asfaltimit dhe disa rrugë me zhavor rreth 400 metra. Në përgjithësi infrastruktura është e mire por megjithatë ju kisha lutur të rishikoni, ta përfshini ndonjë investim.

***Bekim Dobra*** – Nuk po e di me të thane faleminderit nënkryetar apo banor i Vuçakut.

***Kryetari Lladrovci*** **–** Mulla Eset faleminderit që po i shprehni shqetësimet me kohë gjatë formimit të buxhetit dhe ju e dini që ky buxhet për here të pare ka fillu me u zbatu me neve sepse më herët kanë shkuar suficit.

Ju u ndalët për 50 euro tek hapja e varreve, nuk është punë e jona sesi e bëni ju atë kontratë me nënkontraktorët. Ne e kuptojmë jo vetëm shqetësimin e juaj por gjithë akterëve që kemi kontrata të lidhura me ta por që nuk po munden me zhvillu projekte për shkak të krizës globale, rritjes së cmimeve për materialet bazë. Këto janë problem kaluese, por ne kemi kërkuar edhe nga niveli qëndror të marrë një vendim për cdo kontratë, të rritet një përqindje e caktuar për pjesën e mbetur të kontratave por që nuk kemi marrur ende një përgjigje nga ta. Sigurisht që ne do i penalizojmë kompanitë që nuk do i fillojnë punimet. Faktori i Forcës Madhore që që determinon këto procese, nuk kemi Forcë Madhore. Kemi një ngritje të caktuar të çmimeve por ne po flasim për projeksionet buxhetore të viteve vijuese. Unë me ju e kam negociu çmimin, nëse dëshironi të bëjmë shpallje publike për këtë process, ne do bëjmë. Nëse ju dëshironi të ndani këtë process dhe ta bëni shpalljen publike vetëm për hapjen e varrezave edhe atë do e bëjmë por ne jemi të kënaqur me bashkëpunimin me juve por kjo është në dëshirën tuaj. Ne do ta shqyrtojmë këtë por po flas në bazë të asaj që kemi mundësi momentale.

***Kryetari Lladrovci*** – Arben, më vjen mire që je nënkryetar I Komunës dhe i ngritë shqetësimet e Vuçakut, kur kemi ardhur për here të pare kanë qenë afërsisht 300 tendera, ne i kemi grumbullu, për me i zhvillu më lehtë dhe në mënyrë më kualitative, ta zëmë për vendet të ndryshme për shërbimet e nevojshme, sa kanë nevojë për ndricim, rrugë, ujësjellës etj. Të falenderojë për pjesëmarrje në debat dhe kontributin tend në këtë debat.

***Vlora Gjinovci (banore e Qendra I në Drenas)*** – Gjatë analizës së listës së projekteve kapitale nuk po e shoh nga asnjë drejtori që është ngritur si shqetësim tek ndërtesat që janë, tek pjesët e brendshme të banesave, pjesën e shkallëve, dritaret për hyrjet publike, pamja e jashtme, janë punë që kishin mundur me u kry nga ndonjë drejtori sepse është shqetësim nga gjithë banorët.

***Kryetari Lladrovci*** – Faleminderit për pytjen dhe shqetësimin tuaj, duhet të sqarojmë se investimet në objektet kolektive nuk kemi të drejtë me i bë, në qoftë se po mendon për objektin para komunës që nuk është gati pa pronar fare, banuesit brenda janë ozurpator, nëse po mendoni për ndonjë object tjetër, janë dëmtuar nga mbindërtimet që janë leju prej pushteteve të kaluara që kanë deformu e gjithë objektin. Kam problem edhe me pronën që janë të ndërtuar disa nga objektet banesore sepse kanë ndërtuar në prona komunale dhe kur është kërku me marrë komuna pjesën e saj në prone të saj ju është dhënë ballkone të caktuara pa çasje në to, nuk e di sesi e kanë menduar por casje aty mundet me pas veç me ndonjë helicopter se ndryshe nuk kemi çasje. I kemi adresuar këto shqetësime sepse janë pa kurfarë logjike. Ne kemi banesa të ndërtuara në Poklek të Ri, që shumë zyrtarë të Komunës kanë marrë me 50 % ato banesa dhe disa fal krejt, e që pas pak kohe I kanë shitur edhe pse nuk kanë pasur ligjshmëri për veprime të tilla.

# Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor -Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile

***Haki Bekolli (Banor i fshatit Korroticë e Epërme)*** – Përshëndetje kryetar për ju dhe për të gjithë të pranishmit, po flas si banor i fshatit Korroticë e Epërme, është e vërtetë që në fshat është punuar bukur mire, po shoh disa projekte për kanalizim dhe rrugë, pork am një kërkesë në drejtorinë e Urbanizimit, investimi tek Kroni i Mbretit, sepse ai është një ndër kronet më të njohura në Kosovë por i njëjti është në gjendje të mjerueshme. Është mirë që me bë investime në atë vend sepse ka nevojë.

Kam në pytje për punësim, po thotë që në sektorin publik nuk pranohen punësime vetëm me një vendim të qartë për nevojën e punësimeve. Ne qe disa vite jemi pa inspector të mjedisit, kemi paraparë na është hequr, kur e dim cfarë nevoje ka, kisha kërku të fusim inspector të mjedisit.

***Kryetari Lladrovci*** – Faleminderit Haki për shqetësimet dhe kërkesat tuaja, jeni dëshmitar që të Kroni i Mbretit janë bërë investime bukur të mëdha nga investitor të jashtëm dhe është marr uji i pijës të cilin e ka shfrytëzuar shkolla dhe një pjesë e fshatit. Kroni i Mbretit është nënmenaxhimin e kompanisë rajonale të Ujësjellësit në Prishtinë, pas investimeve Komuna e ka për obligim me kry investime dhe me ja dorëzu kompanisë rajonale të ujësjellësit.

Pllaka që është thyer nuk është thyer nga Forca Madhore por nga dora njeriut me çekan. Nuk e kemi vec Kronin e Mbretit, e kemi problem edhe me Kishnarekë sepse nuk po mirëmbahet rezervuari por edhe qytetarët duhet me u lidhë në ujëmatësit që kemi pasur donator por që nuk kanë pranu qytetarët me u lidhë me ujëmatësit.

***Egzona Tërdevci (këshilltare komunale)*** – Faleminderit zotëri Lladrovci, përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për gjithë qytetarët që janë të pranishëm sot, unë kam dy kërkesa është kërkesa për objekt nga Handikos, për të cilën edhe ju jeni në dijeni, unë e kam parasysh për kufizimet buxhetore që ka Komuna por ndoshta kishim mundur adaptu ndonjë objekt ekzistues me përdorur ata. Poashtu është edhe kërkesa për subvencione që e kam paraqitur edhe në seancën e fundit sepse e kanë problem me funksionu ndryshe. E kam edhe një shqetësim por që ndoshta mundemi me rregullu bashkë, unë e kam pare njoftimin për dëgjimet që është bërë edhe në faqe të Komunës, duhet me gjetë një modalitet për njoftim më të mire për qytetarët e Komunës së Drenasit.

***Kryetari Lladrovci*** – Zonja Tërdevci, shqetësimi juaj për Handikosin është edhe shqetësimi jonë, nuk e kemi obligim ajo është OJQ, ja kemi mundësuar objektin që e ka dhe vendin. Pra, jemi në hulumtim të gjetjes së një donatori që të ndërtojmë një objekt të mire për këto shërbime, kemi sjellur mbi 100 mijë euro për karroca për këtë qëllim. Edhe ata duhet të kenë një transparence të shpenzimeve të parave nga donatorët.
Handikosi e ka për obligim me raportu në Komunë dhe me raportu për nevojat e tyre.

***Bekim Dobra*** – Egzonë, ne kemi njoftuar edhe përmes rrjetit social Facebook, në tabela zyrtare, kemi një grup në Viber ku kemi njoftuar administratorët e vendbanimeve, nëpërmjet Drejtorisë së Kulturës kemi njoftuar OJQ-të, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik i kemi thirrur bizneset, Drejtoria e Bujqësisë grupet e interest të bujqëve, fermerëve por nuk është në dorën tonë të i ftojmë me zor në takim.

***Besim Tahiraj (qytetar i Drenasit)*** – Përshëndetje si qytetar i Drenasit deshta me shpreh një shqetësim tek Drejtoria e Planifikimit Urban, ka paraparë vetëm 3 projekte që janë vazhdimësi e viteve të kaluara, nuk po shoh që ka dicka plane apo rregullime të parkingjeve, që janë të domosdoshme për qytetarët, parqe për fëmijë për rekreacione që janë të domosdoshme për qytetarët e Komunës së Drenasit.

***Lladrovci*** – Faleminderit Besim, unë kam marrë shumë pak pike për parkingje, për staze të ciklistave etj. Me grant të përformancës jemi duke e bërë parkingun në prone të hekurudhës sepse nuk kemi vend në prone komunale sepse më herët I kanë shfrytëzu pronat komunale për tjera arsyje e tash po na duhet që të marrim prej hekurudhës prone të tyre që të shfrytëzojmë për parkingje.

***Zahrie Podrimçaku (Banore e Poklekut të ri)*** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë, pasi që është bë ndriçimi për lagjet afër pallateve aty, a kishte pasur mundësi me u bë edhe për pallatet ndriçimi.

Kërkesa e dytë është për çdo dimër bodrumi na rri i mbushur me ujë sepse kanalizimi është jofunksional, prej që jam banore aty kemi vështirësi për këtë çështje sepse kthehet prej së jashti I gjithë kanalizimi. Edhe për gjelbërim pasi ka bë Komuna kërkesën, të paktën 30 fidane me na pru unë përkujdesem vet për to.

***Krytari Lladrovci*** – Objektet nuk kanë pranim teknik dhe nuk kanë përfundu, nuk është dashur të lejohen banorët pa u bë pranimi teknik. Sa i përketë kanalizmeve do të shikojmë mundësitë të mos futet brenda në bodrume dhe do të marrim masa. Ndriçimi do të vjen afër pallateve si në gjithë pjesët e tjera të Komunës  së Drenasit. Sa i përketë pemëve, do të i bijmë nja 30 fidane drejtoresha Fluturë e ka marrë këtë informacion dhe do marrë masat e nevojshme.

***Zahrie Podrimçaku (Banore e Poklekut të ri)*** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë, pasi që është bë ndriçimi për lagjet afër pallateve aty, a kishte pasur mundësi me u bë edhe për pallatet ndriçimi.

Kërkesa e dytë është për çdo dimër bodrumi na rri i mbushur me ujë sepse kanalizimi është jofunksional, prej që jam banore aty kemi vështirësi për këtë çështje sepse kthehet prej së jashti I gjithë kanalizimi. Edhe për gjelbërim pasi ka bë Komuna kërkesën, të paktën 30 fidane me na pru unë përkujdesem vet për to.

***Krytari Lladrovci*** – Objektet nuk kanë pranim teknik dhe nuk kanë përfundu, nuk është dashur të lejohen banorët pa u bë pranimi teknik. Sa i përketë kanalizmeve do të shikojmë mundësitë të mos futet brenda në bodrume dhe do të marrim masa. Ndriçimi do të vjen afër pallateve si në gjithë pjesët e tjera të Komunës  së Drenasit. Sa i përketë pemëve, do të i bijmë nja 30 fidane drejtoresha Fluturë e ka marrë këtë informacion dhe do marrë masat e nevojshme.

***Zahrie Podrimçaku (Banore e Poklekut të ri)- K***ërkojë nga ju të merren masat e nevojshme që të largohen nga objekti banesor antena që janë vendosur pa lejen e banorëve, 5 mijë euro në vit i merr vetëm për një antenë, ju e dini shumë mirë kush i merr aty, unë me Idriz Hysenin e kam pas diskutu këtë cështje por ai nuk ka marrë asnjë veprim se edhe ai e ka një interes për vete aty.

***Krytari Lladrovci*** – The e di, unë asnjëherë nuk e kam ditur që ka antena aty, pra tash kërkojë nga inspektorët përgjegjës të marrin masat e nevojshme dhe të largohet çdo keqbërje sepse është obligim ligjor. Hakiu është këtu, e adreson këtë cështje tek organet dhe shtjellon e verteton këtë punë dhe shkon me procedurat tuaja.

***Afije Veseli (ish banore e Korroticës së Ulët)*** – Unë po flas si ish banore e Korroticës së Ulët, deshta me ditë si qëndron puna e ujësjellësit sepse fshati Korroticë e Ulët dhe Zabel nuk kemi ende ujësjellës.

***Kryetari Lladrovci*** – Ju e dini që kemi stërzgjatje të procesit për marrjen e lejës përgjatë trasesë së rrugës me i fut gypat, ju e dini që gypat që dërgojnë ujin në Komoran kalojnë nëpër Zabel të Ulët e Zabeli nuk ka ujë për vete. Jemi në proces, jemi duke e zhvillu por du me ju thane një gjë shumë të vërtetë sepse edhe kur të bëjmë bazenin funksional në Gllobar nuk ka me pas ujë të mjaftueshëm ose ka me pas me reduktime të mëdha, prandaj Komuna i ka marrur masat e nevojshme dhe ka shpallur interes të përgjithshëm dhe ka bërë fizibilitetin për ujëmbledhësin për Liqenin e Vërbocit, që qyetetarët të kenë ujë të mjaftueshëm, po luftojmë të i kthejmë mjetet nga niveli qëndror sepse janë marrë nga ta. Unë kam vizitë në Francë për këtë qëllim, për realizimin e këtij projekti.

## Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor -Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile

**Bekim Dobra** – *E mbyllë takimin pasi nuk ka pytje tjera për tu parashtruar nga pjesëmarrësit e takimit me përfaqësues të Shoqatave të Bizneseve, OJQ-ve dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile.*

# Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor – Shoqata të bizneseve, OJQ dhe Shoqëri Civile

| | | |
|---|---|---|
| Ramiz Lladrovci | Shyqiri Bublaku | Avdyl Mziu |
| Kryetar i Komunës së Drenasit | Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa | Zëdhënës i Komunës |

Drenas,

08.06.2022